



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142; 22268141

Nr. 1751 Prot.

Tiranë, më 31.10.2017

V E N D I M

Nr. 221, datë 31.10.2017

"Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 87, datë 18.04.2017, 'Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin nr.22, datë 10.02.2017'"

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 87, datë 18.04.2017, të Komisionerit,

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 87, datë 18.04.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin nr.22, datë 10.02.2017".

2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

- | | |
|------------------------------|--|
| 1. Enkelejda Hebibasi | Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |
| 2. Stela Ndoka | Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |

3. **Migena Haznedari** Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

3. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt dhe grumbullimin e të dhënave që materializojnë zbatimin e vendimit në datat **8 dhe 9 nëntor 2017**.
4. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Relacioni duhet të përpilohet deri në datën **18.12.2017**. Më pas do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohet vendimi për përmbylljen e procesit, brenda datës **26.12.2017**.
5. Vendimi përfundimtar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e verifikimit do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur, Bashkisë Mallakastër dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të verifikimit me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë
22268141

Tel 04 22268142;

Nr. 1751/1 Prot.

Tiranë, 31.10.2017

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

"Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 87, datë 18/04/2017, 'Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin nr.22, datë 10.02.2017'".

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Bashkia Mallakastër**
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit paralajmërues nr.87, datë 18.04.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin nr.22, datë 10.02.2017", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Rregullorja "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 4. Afati i verifikimit:** Verifikimi do të kryhet në institucion në datat **8 dhe 9 nëntor 2017.**
- 5. Procedura që do të ndiqet:** Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.
- 6. Grupi i punës:** **1. Enkelejda Hebibasi** Drejtor i Çështjeve

Juridike dhe
Marrëdhënieve me
Jashtë

2. Stela Ndoka

Specialist, Drejtoria
Çështjeve Juridike
dhe Marrëdhënieve
me Jashtë

3. Migena Haznedari

Specialist, Drejtoria
e Çështjeve Juridike
dhe Marrëdhënieve
me Jashtë

**7. Dokumentimi i rezultateve të
verifikimit:**

Në përfundim të procesit të verifikimit do të përgatitet relacioni përkatës nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtura në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (*n.q.s vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar*).

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

I. Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin nr. 87, datë 18.04.2017 "Mbi përfundimin e procedit të verifikimit , filluar me Vendimin nr. 22, dt. 10.02.2017", nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:

1. *Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër të anulojë pikat 1 dhe 2, të aktit administrativ nr. 204, datë 18.08.2016, që emëron në detyrë respektivisht punonjësit:*

✓ ******, (pika 1, e aktit), në pozicionin "Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Pyjeve", pranë Bashkisë Mallakastër;*

✓ ******, (pika 2, e aktit), në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arkivi dhe IT", pranë Bashkisë Mallakastër.*

2. Njësia përgjegjëse të hartojë planin e punës së pranimeve në shërbim civil për vitin 2017, duke përfshirë pozicionet e punës më sipër dhe pozicionet e punës të plotësuara në kundërshtim me ligjin, të cilat janë evidentuar dhe trajtuar më parë nga Komisioneri në vendimin nr. 81, datë 19.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 334 prot., datë 18.04.2016” dhe që njësia përgjegjëse nuk i ka plotësuar ende me anën e procedurave të konkurrimit.
3. Pozicionet në fjalë, duhen shpallur si të lira dhe të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.
4. Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të përmbush rregullat e përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.
5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër, të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

- II. Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.
 1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
 2. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të verifikimit.

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË
Enkelejda HEBIBASI**